



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës/ Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KONTRATË

KOMUNA E PODUJEVËS (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

N.T.P "Dita", Podujevë, me NrB:70057054 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

Transporti i nxënësve për pjesëmarrje në gara të ndryshme si dhe administratorëve për administrim të testit të maturës me numër Identifikues 615-19-1855-2-3-6, nr i brendshëm: 61519033236

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Transporti i nxënësve për pjesëmarrje në gara të ndryshme si dhe administratorëve për administrim të testit të maturës
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me 10 qershor 2019 dhe përfundon më 10 qershor 2020
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se një ditë nga data e marrjes së urdhëresës.
- 1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jenë: Podujevë

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **4,070.00 €; [katërmijëeshtatëdhjetëeuro].**
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

- 4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj pas pranimit të shërbimeve

- 4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është

regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkeshat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përpunim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktuje pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njofimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal

që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Menaxher i projektit do të jetë: z. Adem Ajvazi, nr tel. 044/825-779

E hartuar në gjuhen Shqipe në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	z. Hajdar Dili	Emri:	Rasim Fejza
Pozita:	Drejtës	Pozita:	u.d i menaxherit të DP
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	10/06/2019	Data:	10/06/2019
Vula:		Vula:	

